# Fleksibiliteti i Heqjes nga ESEA(Akti i Shkollimit në Shkollat Fillore dhe të Mesme)
# Përcaktimi i Identifikimit të Shkollave për Title I

| | Në Fokus | Në Përparësi | Në Shpërblim (Arritje të Larta) | Në Shpërblim (Progres i Lartë) |
|---|---|---|---|---|
| Kriteret për Përcaktimin | **10** Përqindshi i fundit i shkollave të Title I: (bazuar në mangësitë më të mëdha e të vazhdueshme, në arritjet e nxënësve në Objektivat e Matëshme Vjetore (Annual Measurable Objective). Mangësitë e arritjeve janë si kombinim i testimeve në matematikë/lexim të PSSA, dhe/ose Algjebra I/Letërsi në Keystone.<br><br>OSE<br><br>• Shkollat e Title I me shkallë diplomimi poshtë 60 përqind<br><br>OSE<br><br>• Pjesëmarrja në Teste poshtë **95** përqind DHE nuk është Shkollë me Përparësi. | .<br>• **5** Përqindshi i fundit i shkollave të Title I: (Mangësitë e arritjeve janë si kombinim i testimeve në matematikë dhe lexim të PSSA, dhe/ose Algjebra I/Letërsi në Keystone.<br><br>OSE<br><br>• Shkollë e Title që merr fonde për përmirësim (School Improvement Grant) (SIG). | • **5** Përqindshi i parë i shkollave të Title I: (arritjet janë si kombinim i testimeve në matematikë dhe lexim të PSSA, dhe/ose Algjebra I/Letërsi në Keystone.<br><br>DHE<br><br>• Arrin të gjitha Objektivat e Matëshme Vjetore (Annual Measurable Objectives) (AMOs). (Shënim: Për të dhënat e vitit 2012-13, mbyllja e mangësive nuk do të vlerësohet si vit që do të fillojnë matjet.)<br><br>DHE<br><br>• nuk është Shkollë me Përparësi ose Shkollë në Fokus. | • Për vitet shkollore 2011-12 dhe 2012-13: **5** Përqindshi i parë i shkollave të Title I bazuar në arritjet që janë si kombinim i arritjeve në PVAAS në matematikë dhe lexim të PSSA, dhe/ose Algjebra I/Letërsi në Keystone, për të gjithë nxënësit.<br><br>OSE<br><br>• Për vitin shkollor 2013-14 dhe në vazhdim: **5** Përqindshi i parë i shkollave të Title I bazuar në arritjet që janë si kombinim i arritjeve për mbylljen e prapambetjes në matematikë dhe lexim në PSSA, dhe/ose Algjebra I/Letërsi në Keystone, kombinuar për të GJITHE nxënësit dhe “ grupin historikisht të prapambetur” të nxënësve.<br><br>DHE<br><br>• Arrin të gjitha Objektivat e Matëshme Vjetore (Annual Measurable Objectives) (AMOs). (Shënim: Për të dhënat e vitit 2012-13, mbyllja e mangësive nuk do të vlerësohet si vit që do të fillojnë matjet.)<br><br>DHE<br><br>• Nuk kanë Shpërblim: Shkolla me Arritje të Lartë, Shkolla në Fokus, ose Shkollë në Përparësi. |

| | Në Fokus | Në Përparësi | Në Shpërblim (Arritje të Larta) | Në Shpërblim (Progres i Lartë) |
|---|---|---|---|---|
| Kërkesat | • Çdo shkollë në Fokus duhet të implementojë më së paku një ndërhyrje që lidhet me Objektivat e Matëshme Vjetore, që nuk janë arritur.<br><br>• Shkollat e përcaktuara si shkolla në Fokus, bazuar në të dhënat e vitit 2012-13, do t'u kërkohet të implementojnë një Plan Gjithëpërfshirës të Përmirësimit.<br><br>• Kërkohen konsultime me njësi të ndërmjetëme dhe rrjetin e Pennsylvania Training and Technical Assistance Network (PaTTAN) (në përputhje me nevojat).<br><br>• Duke filluar nga viti shkollor 2014-15, drejtoria arsimore do të lerë mënjanë 20 përqind të fondit të saj të Title I, për ndërhyrjet e kërkuara. | • Të gjitha Shkollat në Përparësi, kërkohet të implementojnë ndërhyrje që lidhen me shtatë parimet e përmirësimit të shkollës.Mënyra dhe shkalla e qasjes së këtyre parimeve mund të ndryshojë në vartësi të nevojave unike të nxënësve në secilën shkollë.<br><br>• Në kohën e njoftimit nga shkollat do të kërkohet të rishikojnë planin egzistues të përmirësimit të shkollës.<br><br>• Duke filluar nga viti shkollor 2014-15, drejtoria arsimore do të lerë mënjanë 20 përqind të fondit të saj të Title I, për ndërhyrjet e kërkuara.<br><br>• Shkollat zhvillojnë planin e përmirësimit bazuar në ndërhyrjet e nevojshme, që janë identifikuar për kthimin e situatës, duke përdorur Mjete Planifikimi Gjithëpërfshirëse. | | |